

SERIA 1:

PROFESIONI I KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT, PRAPA NUMRAVE

Tetor 2015



International
Federation
of Accountants®

"Pika në të cilën nevoja për mendim strategjik plotëson profesionin e kontabilitetit dhe auditimit është lidhja në të cilën vendimmarrja e duhur ndihmon në forcimin e organizatave dhe përparimin e ekonomive, në interes të publikut. "

– Fayez Choudhury, Kryeshef Ekzekutiv në FNK



International
Federation
of Accountants®

Në vitin 2015, FNK angazhoi konsulentët e pavarur të ekonomisë dhe hulumtimit të biznesit - Cebr, për të analizuar të dhënat tona të anëtarësisë nga viti 2009 në 2013.

Seria 1: Profesionit i Kontabilitetit dhe Auditimit, Prapa Numrave, është i pari nga dy raportet që pasqyrojnë analizën e Cebr dhe ofron një pamje të rëndësishme të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit për ekonominë globale dhe kontributin e saj në shoqëri.

Draftet, Dokumentet e Konsultimit dhe botime të tjera të FNK janë të botuara nga FNK dhe të drejtat e autorit i posedon FNK.

FNK nuk pranon përgjegjësi për humbjen e shkaktuar ndaj çdo personi që vepron ose përmbahet nga veprimi duke u mbështetur në materialin në këtë botim, pavarësisht nëse humbja e tillë është shkaktuar nga neglizhenca ose ndryshe.

Logo e FNK, 'Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve' dhe 'FNK' janë marka tregtare dhe marka shërbimi të FNK.

Të drejtat e autorit © Tetor 2015 nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK). Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Kërkohet leja me shkrim nga FNK për të riprodhuar, ruajtur ose transmetuar, ose për të bërë përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti, përveç siç lejohet me ligj. Kontaktoni permissions@ifac.org.

ISBN: 978-1-60815-254-4

SERIA 1: PROFESIONI I KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT, PRAPA NUMRAVE

Pika në të cilën nevoja për mendim strategjik plotëson profesionin e kontabilitetit dhe auditimit është lidhja në të cilën vendimmarrja e duhur ndihmon në forcimin e organizatave dhe përparimin e ekonomive, në interes të publikut.

Në fillim të këtij viti, FNK njoftoi se numri i kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë të përfaqësuar nga 175 + organizatat tona anëtare në mbi 130 vende dhe juridiksione kishte arritur në 2.84 milion. **Seria 1: Profesionit i Kontabilitetit dhe Auditimit, Prapa Numrave** siguron detaje dhe njohuri prapa këtij numri.

Pamja e përgjithshme për plotësimin e kërkesës së fuqishme globale për kontabilistët dhe auditorët profesionistë është shumë inkurajuese. Rritja e profesionit është një tregues i qëndrueshmërisë së tij si në kohë të mira ashtu edhe në të këqija - dhe një mesazh i fuqishëm për të rinjtë duke marrë parasysh mundësitë e karrierës.

Kontabilistë dhe Auditorët profesionistë të besueshëm dhe kompetentë janë integruar vlerash që ofrojnë këshilla strategjike dhe ndihmojnë në kuptimin e ndryshimit të peizazheve rregullatore, pavarësisht nga kushtet ekonomike.

Raporti thekson rëndësinë e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë për ekonominë në rritje dhe krahason rritjen e profesionit me rritjen totale të punësimit brenda rajoneve. Ai gjithashtu tregon se sa thellë është ngulitur profesioni global në të gjithë shoqërinë: në praktikat publike, bizneset dhe industri, sektorin publik dhe në akademi. Pamja e përgjithshme tregon një profesion të kërkuar, duke u rritur në mënyrë të qëndrueshme dhe duke dhënë kontribute të konsiderueshme në të gjitha fushat e shoqërisë.

Ka shumë arsye pse njerëzit anëtarësohen në një organizatë profesionale të kontabilitetit dhe auditimit (OPK) dhe shumë arsye pse OPK-të kërkojnë anëtarësim në FNK. Ky raport thekson të dy çështjet.

rritja nga anëtarët tanë dhe pranimi i OPK-ve të reja si anëtarë të FNK pasi plotësuan kriteret tona të vlerësimit të fortë. Thelbësore në historinë e profesionit global të kontabilitetit dhe auditimit janë standardet ndërkombëtare me cilësi të lartë, duke përfshirë një Kod të Etikës për Kontabilistët dhe Auditorët Profesionistë dhe Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësimit (DOA), të cilave u përmbahen organizatat anëtare të FNK, dhe që vendosin interesin publik në zemër të gjithçka që arrijnë kontabilistët dhe auditorët profesionistë.

FNK është krenare që është organizata globale për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, përmes organizatave tona anëtare, për të mbështetur miliona lkontabilistë dhe auditorë profesionistë, të cilët çdo ditë shkojnë në punë dhe marrin vendime në interes të publikut.

Fayez Choudhury
Kryeshef Ekzekutiv në FNK



GJETJET KYÇE

1

Organizatat Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit (OPK) të FNK po rriten në mënyrë organike

Numri i kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë të cilët janë anëtarë të OPK-ve të FNK u rrit 16%, nga 2.4 milion në 2.8 milion. Përafërsisht dy të tretat e kësaj rritje ishte organike; një e treta ishte rezultat i OPK-ve shtesë që ju bashkuan FNK.

2

Evropa vazhdon të jetë rajoni më i madh; Afrika dhe Lindja e Mesme kishin rritjen më të madhe

Evropa kishte numrin më të madh të anëtarëve të OPK-ve në FNK gjatë kësaj periudhe. Afrika dhe Lindja e Mesme kishin numrin më të vogël, por ato kishin rritjen më të konsiderueshme gjatë periudhës me rreth 25%.

3

OPK-të e FNK u zhvilluan më shpejt se rritja totale e punësimit.

Pasqyrimi i pjesëmarrësve të rinj në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, rritja e anëtarësisë në OPK-të e FNK tejkaloi ndjeshëm rritjen totale të punësimit në të gjitha rajonet, përveç njërit. Në ekonominë e zhvilluara, OPK-të u rritën me 20%, megjithë rritjen e ngadaltë të punësimit total; në vendet më pak të zhvilluara dhe në grupin e madh të ekonomive MINT, me rritje të shpejtë, OPK-të e FNK u rritën përkatësisht 17% dhe 18%.

4

Ekziston një mundësi e madhe globale e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit

Bazuar në statistikën kombëtare, Cebr vlerëson se anëtarët e OPK-ve të FNK përfaqësojnë vetëm një të tretën e atyre që punojnë në fusha të lidhura me kontabilitetin dhe auditimin në të gjithë botën.

5

Kontabilistët dhe Auditorët janë të përfshirë në të gjithë shoqërinë

Shumica e anëtarëve të OPK-ve të FNK janë kontabilistë dhe auditorë që punojnë në biznes dhe industri, sektorin publik dhe akademinë; pak më shumë se 45% punojnë në praktika publike.

SFIDAT DHE MUNDËSITË

Ky studim i statistikave të anëtarëve të OPK-ve të FNK identifikoi një numër trendesh, mundësish dhe sfidash për profesionin global, përfshirë:

Ruajtja dhe rritja e vlerës së profesionit

Në shumë vende dhe juridiksione, njerëzit mund të referohen si kontabilistë dhe auditor pa ndonjë trajnim zyrtar ose kualifikim profesional dhe, siç thekson gjetja 4, ekziston një numër i konsiderueshëm i individëve që punojnë brenda ose paralelisht me profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në të gjithë botën. Si mund të shfrytëzohet dhe profesionalizohet ky grup i madh talentësh për të siguruar ofrimin e shërbimeve të ekspertëve të kontabilitetit dhe auditimit të ofruara nën një kornizë të standardeve rigorozë globale? Çfarë mund të bëhet më shumë për të promovuar diferencimin e një kontabilisti apo auditori profesionist?

Artikulli më i mirë i vlerës së kontabilistëve dhe auditorëve në shoqëri

Anëtarët e OPK-ve të FNK janë tërhequr nga një sektor i gjerë i shoqërisë. Ata punojnë në sektorin publik, në biznes dhe industri, dhe në akademi, si dhe në praktika publike. Këta kontabilistë dhe auditorë u shtojnë vlera organizatave dhe komuniteteve dhe mbështesin stabilitetin ekonomik global. Si mund të theksohet më mirë roli i kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë si këshilltarë strategjikë biznesi - integrues vlerash që drejtojnë performancën e biznesit dhe adresojnë kërkesat e qeverisjes dhe raportimit, në interes të publikut - që të jenë të theksuara në mënyrë të duhur?

Konkurrojnë me sukses për talentët më të mirë

Rritja e anëtarësisë të OPK-ve të FNK tejkaloi rritjen totale të punësimit në pothuajse të gjitha rajonet e botës. Çfarë mund të bëjnë më shumë kontabilistët dhe auditorët profesionistë për të komunikuar qëndrueshmërinë e profesionit tonë? Cilat metoda të reja duhet të vendosen për të garuar për një karrierë më të mirë dhe më të ndritshme që është e rëndësishme, frymëzuese dhe që bën një ndryshim për komunitetet?

ANËTARTËT E FNK VAZHDOJN TË RRITE NË MËNYRË ORGANIKE

Ekzistojnë dy mënyra që ndikojnë në rritjen e FNK: ose përmes organizatave anëtare që zgjerojnë anëtarësitë e tyre në mënyrë organike, ose duke pranuar OPK të reja - të cilat kanë përmbyshur një proces të fuqishëm - në federatën e saj globale.

Në mes 2009 dhe 2013,

Anëtarët e FNK përjetuan rritje të qëndrueshme.

Numri i kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë të cilët janë anëtarë të OPK-ve të FNK u rrit nga

2.4 MILION në 2.8 MILION,
një rritje prej **16%**




Në përgjithësi, mbi dy të tretat e kësaj rritje ishte organike dhe një e treta ishte si rezultat i OPK-ve shtesë që u bashkuan në FNK. Përjashtimi i vetëm nga kjo prirje ishte 2012, kur dy OPK të mëdhenj u bënë anëtare të FNK.



2/3 rritje organike

RRITJA E ANËTARËSISË SË OPK-VE NË FNK, SIPAS LLOJIT TË RRRITJES

Miliona



■ Ekzistuese ■ Rritje organike ■ OPK-të shtesë

OPK-TË E FNK U RRIJEN MË SHPEJT NË AFRIKË DHE LINDJEN E MESME

Përqindja më e madhe e anëtarësisë në OPK-të e FNK është në Evropë - pak më pak se një milion. Gjatë periudhës, ky rajon gjithashtu gëzoi një rritje të fuqishme - anëtarësia e anëtarëve tanë evropianë u rrit me 834,000 në 981,000. Që nga viti 2009, shumë nga OPK-të e reja të FNK janë bashkuar nga Evropa.



RAJONI MË I VOGËL ËSHTË AFRIKA - LINDJA E MESME, ME

126,000 ANËTARË TË OPK-VE TË FNK.


MEGJITHATË, KY RAJON PËRJETOI RRIJTEN MË TË MADHE TË ANËTARËSISË TË OPK-VE NË FNK GJATË PERIUDHËS, DUKE U RRIJTUR ME

25%

Përafërsisht një e katërta e anëtarësisë së OPK-ve të FNK është në Azi, me shumicën e këtyre kontabilistëve dhe auditorëve që veprojnë në Indi dhe Kinë.


ANËTARËSIA E OPK-VE NË FNK

MILIONA



RRIJTJA E ANËTARËSISË SË OPK-VE NË FNK KUNDREJT RRIJTJES TOTALE TË PUNËSIMIT, SIPAS RAJONEVE

2009-2013



Rritja e anëtarësisë së OPK-ve në FNK ishte dukshëm më e madhe se rritja e përgjithshme e punësimit në të gjithë botën, me përjashtim të Amerikës Latine dhe Karaibeve. Pjesë e arsyes për këtë ishte rritja jashtëzakonisht e shpejtë e punësimit total në Amerikën Latine - niveli i dytë më i shpejtë i çdo rajoni.


ANËTARËSIA U RRIT NDJESHËM NË EKONOMITË MË PAK TË ZHVILLUARA DHE MINT

Një element kyç i misionit të interesit publik të FNK është mbështetja e ndërtimit të kapaciteteve të OPK-ve në vendet në zhvillim - punë që është thelbësore për stabilizimin dhe fuqizimin afatgjatë të ekonomive që kanë përjetuar trazira të konsiderueshme dhe, shpesh, zhvendosje sociale dhe varfëri.



ANËTARËSIA E OPK-VE TË FNK DHE RRIJTJA TOTALE PËR PERIU DHËN, SIPAS GRUPIMEVE TË VENDEVE


Miliona



FNK punon me partnerët dhe anëtarët tanë ndërkombëtarë MOSAIC për të mbështetur zhvillimin e OPK-ve në ekonomitë që kanë shumë për të përfituar nga profesioni i fuqishëm i kontabilitetit dhe i auditimit.

RRITJA E ANËTARËSISË SË OPK-VE NË FNK KUNDREJT RRIJTJES TOTALE TË PUNËSIMIT, SIPAS GRUPEVE TË VENDEVE

2009-2013



Kjo përpjekje e madhe dhe e rëndësishme ndërkombëtare ka filluar të japë fryte. Nga një bazë e ulët, anëtarësia e OPK-ve në FNK në kombet më pak të zhvilluara dhe grupi i madh, me rritje të shpejtë i ekonomive të MINT (Meksikë, Indonezi, Nigeri dhe Turqi) u rritën përkatësisht me 17% dhe 18%.

VENDET MË PAK TË ZHVILLUARA

RRITJA 17%

VENDET E MINT

RRITJA 18%

EKONOMITË E ZHVILLUAR NË RRIJTJE




Numri i kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në ekonomitë e zhvilluara u rrit me 20%, përkundër rritjes më të ulët të punësimit total. Ekonomitë BRIK, me rritje të ngjashme të përgjithshme të punësimit, kishin rritje më të ulët të anëtarësimit në OPK-ve në FNK sesa ekonomitë e zhvilluara.

KONTABILISTËT DHE AUDITORËT SI PJESE E SHOQËRISË NË TË GJITHA EKONOMITË GLOBALE

Përqindja më e madhe e kontabilistëve dhe auditorëve në shoqëri - rreth 1.4 milion - punojnë jashtë praktikave publike. Ato ndihmojnë organizatat të implementojnë qeverisje më të mirë të korporatave, shpesh drejtojnë ngarkesën për qëndrueshmërinë e korporatave dhe zbatimin e të menduarit të integruar dhe ndihmojnë në krijimin e një sektori publik më efikas dhe transparent. Ata gjithashtu punojnë në akademi për të ndihmuar në edukimin e gjeneratave të ardhshme të udhëheqësve si dhe për të bërë bërë hulumtime të vlefshme.




ANËTARËSIA E OPK-VE TË FNK, NGA SEKTORI 2013



Gjatë periudhës së studimit, përqindja e anëtarëve të OPK-ve të FNK të punësuar në secilin sektor mbetet kryesisht e qëndrueshme, me pak më shumë se 55% punojnë jashtë praktikave publike.

■ Praktika Publike ■ Biznes dhe Industri ■ Sektor Publik ■ Akademi/Edukim

Si këshilltarë biznesi, kontabilistët dhe auditorët janë thelbësorë në fuqizimin e aranzhimeve të qeverisjes dhe raportimit të korporatave. Pavarësisht nëse organizatat janë duke adresuar projekte të mëdha, ose administrim të qëndrueshëm të gjashtë formave të kapitalit, kontabilistët dhe auditorët profesionistë janë thelbësorë për shpërndarjen e suksesshme, transparente dhe të përgjegjshme.



EKOLOGJIA GLOBALE E KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT DHE MUNDËSIA PËR RITJE TË PROFESIONALIZMIT.

Bazuar në termat e referencës të punës dhe të dhënat e përgatitura nga qeveritë dhe juridiksionet në të gjithë botën, Cebr ka identifikuar një numër të konsiderueshëm të njerëzve që punojnë në ekologjinë globale të kontabilitetit dhe auditimit. Cebr vlerëson se OPK -të e FNK përfaqësojnë një të tretën e kësaj ekologjie globale.



Dy të tretat e mbetura janë, p.sh. individ që identifikohen si kontabilistë apo auditorë - por juridiksioni i të cilëve mund të mos kërkojë trajnim profesional ose kualifikim - dhe njerëz që identifikojnë rolin e tyre si një funksion mbështetës i kontabilitetit dhe auditimit.



i Përkufizimi i Evropës përmban Evropën Lindore, Turqinë, Rusinë dhe Ukrainën.

ii Më pak i zhvilluar (përkufizimi i BE): 48 vende, përfshirë pjesën më të madhe të Afrikës nën-Sahariane, pjesët më të varfra të Azisë, Amerikën Qendrore.

iii MINTA: Meksika, Indonezia, Nigeria, Turqia.

iv BRIC: Brazili, Rusia, India, Kina.

v Tregjet në zhvillim (përkufizimi i FMN-së): 154 vende, përfshirë pjesën më të madhe të Afrikës, Amerikës së Jugut, Azisë dhe pjesëve të Evropës Lindore.

vi Ekonomitë e Avancuara (Përkufizimi i FMN-së): 35 vende duke përfshirë pjesën më të madhe të Evropës Perëndimore, Amerikën e Veriut, Australi, pjesë të Azisë.

vii MOSAIKU: Memorandum i Mirëkuptimit për Fuqizimin e Kontabilitetit dhe Auditimit dhe Përmirësimin e Bashkëpunimit (www.ifac.org/mosaic).